



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
SEKRETARIATI**

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Komisioni i Arsimit

Datë 24.07.2025

Lenda: “PËR PËRMIRËSIM TË SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË KOPSHTEVE TË BASHKISË KAVAJË”, “PËR KTHIMIN PJESËRISHT TË KOPSHTEVE TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE GOLEM DHE LUZI VOGËL NË KOPSHTE ME USHQIM”.

Analiza ligjore:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë Neni 57, pika 1, ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” i ndryshuar, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”, Ligjit Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2018, Urdhrit Nr. 31, datë 28.01.2020, “Për miratimin e Rregullores për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”; Kreu II, “Arsimi Parashkollor”, Udhezimit nr.14 date 10.7.2023 “Per numrin e nxenesve per klase dhe ngarkesen mesimore te punonjesve arsimore”, VKB Nr. 68 datë 23.12.2024, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetit të vitit 2025”.

Situata aktuale e funksionit:

Referuar relacionit përmbledhës të përgatitur nga Agjencia e Arsimit Parashkollor, Bashkia Kavajë dërguar këshillit bashkiak, rezulton se:

Kërkesa në rritje të prindërve për shërbimin e drekës, ka bërë që fëmijët e zonës Golem dhe Luzi Vogël, të regjistrohen në kopshtet e qytetit Kavajë dhe në këtë mënyrë, kopshtet që e ofrojnë këtë shërbim, të jenë mbi kapacitet. Kjo për pasojë, ka sjellë shpenzime të paparashikuara për familjarët e zonës së Golemit dhe të Luzit të Vogël. Regjistrimet mbi kapacitet në qytet sjellin gjithashtu edhe probleme në efikasitetin e ulët gjatë procesit të edukimit dhe nxënies së fëmijës.

Planifikimet e mbështetura edhe në kërkesat me shkrim të prindërve të fëmijëve, janë që të kthehet në kopsht me ushqim fillimisht njëri nga grupet dhe në vitin 2025 - 2026 edhe grupi tjetër në varësi të kërkesave të komunitetit.

Për të gjitha këto arsye, është e rëndësishme që kopshti Golem dhe kopshti Luzi Vogël pa ushqim, të mund të kthehet në kopsht me ushqim pasi i përmbushin të gjitha standartet infrastrukturore dhe në këtë mënyrë, plotësojmë kërkesat në rritje të banorëve të zonës.

Nr	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Fakt Aktual
1.	Numri i fëmijëve që frekuentojnë çdo ditë kopshtin	Golem	112
2.	Numri i fëmijëve të regjistruar në kopsht me ushqim	Golem	50
3.	Numri i fëmijëve të regjistruar në kopsht pa ushqim	Golem	62

Nr	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Fakt Aktual
1.	Numri i fëmijëve që frekuentojnë çdo ditë kopshtin	Luzi Vogël	52
2.	Numri i fëmijëve të regjistruar në kopsht me ushqim	Luzi Vogël	25
3.	Numri i fëmijëve të regjistruar në kopsht pa ushqim	Luzi Vogël	27

Për sa më sipër kërkohet:

1. Në Arsimi Parashkollor dhe Shërbimet Mbështetëse të Arsimit Parashkollor, Parauniversitar dhe Qendrat Kulturore, hapjen e kopshteve me ushqim në Njësitë Administrative Golem dhe Luzi Vogël.
2. Në Arsimi Parashkollor dhe Shërbimet Mbështetëse të Arsimit Parashkollor, Parauniversitar dhe Qendrat Kulturore, shtohet numri i punonjësve me 11 (njëmbëdhjetë) duke përfshirë dy kuzhinierë, dy ndihmës kuzhinierë, tre edukatore, një pjatlarëse, një sanitare dhe dy roje, sipas lidhjes nr 2.

Nr.	Pozicioni	Paga Baze	Vjetërsia (15vite)	Paga Baze	Paga Neto
1.	Kuzhinierë	46800	7020	53.820	45.346
2.	Nd.kuzhinierë	45000	6750	51.750	43.777
3.	Pjatlarëse	44000	6600	50.600	42.905
4.	Sanitare	44000	6600	50.600	42.905
5.	Roje	44000	6600	50.600	42.905
6.	Edukatore				
	Totali per 1 muaj			257.370	217.838
	Totali per 1 vit			3.088.440	2.614.056

Impakti Financiar:

Fonde nga buxheti i bashkisë Kavajë. Fondet nga buxhet i trashëguar me VKB nr. 06 date 25.02.2025.

Drejtoria/Spektori pergjegjes:

Agjencia e Arsimit Parashkollor, Bashkia Kavajë

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria përkatëse dhe Këshilli Bashkiak Kavajë

Impakti social/grupet qe preken:

Fëmijët banorët në Njësitë Administrative të Luzi Vogël dhe Golem

A eshte objekt konsultimi:

Jo

Komisioni i perhershëm i Arsimit u mbledhë më datë 24.07.2025 dhe shqyrtoi projekt-vendimin **“PËR PËRMIRËSIM TË SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË KOPSHTEVE TË BASHKISË KAVAJË”, “PËR KTHIMIN PJESËRISHT TË KOPSHTEVE TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE GOLEM DHE LUZI VOGËL NË KOPSHTE ME USHQIM ”**, relacionin dhe dokumentat shoqerues te tij.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozoje Keshillit bashkiak:

- a- Kalimin e projektaktit ne mbledhjen e Keshillit per vleresimin e metejsheëm dhe per shqyrtim
- b- Miratimin e projekt aktit
- c- Refuzimin e miratimit te projektaktit
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:

Anëtarët e Komisionit

Valbona Mustafa

Meleqe Kazazi

Shqipe Baulja

Rovina Aliaj

Enea Stefa

Kryetar

Nen/Kryetar

Anetar

Anetar

Anetar

